REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE DHE MBROJTJES SË TERRITORIT
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

PROJEKT VENDIM

Nr. 66, Date 25/08/2026

"Per miratimin e kerkeses se Bashkise Devoll se bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor per akordimin e ndihmes financiare per familjen e Z. Xhimi Fezo , banues ne fshatin Bitinckë , Njesia Administrative Qendër Bilisht , banesa e te cilit eshte djegur pjesërisht.

Ne mbeshtetje te nenit 113 pika 2 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, nenit 54 germa "e" te Ligjit nr. 139/2015 " Per veteqeverisjne vendore" I ndryshuar, ne Ligjin Nr.45/2019 "Per mbrojtjen Civile" Neni 30 pika gj , "Bashkite kryejne vlersimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesite ne territorin e tyre, vlersimin e nevojve per perballimin e tyre, si dhe demshperblejne shtetasit per fatkeqesine e ndodhur ne territorin e tyre". Vendimit Nr.329, date 16.05.2012 "Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shteterore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesite natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerzore"

PROPOZOJ:

1- Të miratojë mbeshtetjen financiare per familjen **Z.Xhimi Fezo** per demtimin e baneses si pasoje e renies se zjarrit.

2-Te miratoje masen e demit financiar te kesaj familje ne vleren totale eshte **163,867 (Njëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë**

Kjo vlere do te perballohet nga fondi i Emergjencave Civile dhe Bashkise i destinuar dhe i miratuar nga Keshilli i Bashkise Devoll nga Buxheti i vitit 2026.

3-Ndihma financiare qe do te akordohet do te perdoret per ti ardhur ne ndihme familjes se shtetasit
Z Xhimi Fezo banesa e te cileve eshte e djegur pjesërisht si pasoje e zjarrit te ne daten 31.07.2026.

4- Per zbatimin e ketij urdheri ngarkohet Sektori i Emergjencave Civile, Drejtoria e Sherbimeve Financiare dhe Sektori i Planifikimit te Buxhetit..

5.Ky vendim hyn ne fuqi sipas nenit 55 pika 6 e ligjit 139/2015 “Per Veteqeverisjen Vendore” I ndyshuar .

SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

PERGJEGJESI
Yllson STENA

SEKTORI JURIDIK

PERGJEGJESI
Eriksela AVDO

KRYETARI I BASHKISË

EDUARD DURO

Adresa: Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9; Tel+35581122288; E-mail: bashkiadevoll@gmail.com; Ëeb: http://bashkiadevoll.gov.al/

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE DHE MBROJTJES SË TERRITORIT
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 3297 **Prot.** **Bilisht më** 25 / 08 /**2026**

RELACION

Lënda: Miratimi mbi vlerësimin e dëmeve nga ana ndërtimore dhe dëmeve në orendi për familjen e z. Xhimi Fezo banues i fshatit Bitinckë Bashkia Devoll .

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Devoll.

Në datën 31.07.2026 banesa një katëshe e shtetasit Xhimi Fezo në fshatin Bitinckë,Njësia Administrative Qendër Bilisht u përfshi nga flakët e zjarrit dhe si rezultat me gjithë ndërhyrjen e banorëve të fshatit, Strukturave të Zjarfikëses Devoll dhe Policisë objekti u dogj pjesërisht.Nga zjarri u dogj një pjesë e verandës të shtëpisë dhe banja.

Kryetari i Bashkisë me Urdhërin Nr.335 date 03.08.2026 "Ngriti komisionin e Konstatimit dhe të Vlerësimit të gjendjes për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësia".

Konform ***Ligjit Nr.45/2019 "Për mbrojtjen Civile" Neni 30 pika gj,"Bashkitë kryejnë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë në territorin e tyre, vlersimin e nevojve për përballimin e tyre, si dhe demshpërblejnë shtetasit për fatkeqësinë e ndodhur në territorin e tyre", Vendimit Nr.329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore".***

Nga ana e komisionit të Konstatimit është bërë konstatimi i dëmeve në banesën Z.Xhimi Fezo banues në fshatin Bitinckë,Njësia Administrative Qendër Bilisht dhe nga ana e Komisiont të Vlerësimit është bërë vlerësimi i dëmeve dhe është mbajtur proces-verbali me të gjitha zërat sipas dëmeve të shkaktuara në orendi dhe materiale dhe në bazë të proces-verbalit te vleresimit jane hartuar preventivat me vleren e demit ne orendi dhe ne material ndërtimi konform të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore nga ana e specialistëve të Bashkisë Devoll.